



**BASHKIA TIRANË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr.16 datë 25.06.2014

**PËR**

**“EMËRTIMIN “SHËTITORJA E KATEDRALES”, TË RRUGËS NGA SHESHI SKËNDERBEJ, NË KRYQËZIMIN MIDIS MINISTRISË SË ENER GjITIKËS DHE MINISTRISË SË BUJQËSISË, DERI NË KRYQËZIMIN ME RRUGËN “IBRAHIM RUGOVA”, NGJITUR ME KATEDRALIA ORTODOKSE (E RE) “NGJALLJA E KRISHTIT”**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin për emërtimin “Shëtitorja e Katedrales”, të rrugës nga sheshi Skënderbej, në kryqëzimin midis Ministrisë së Energjitikës dhe Ministrisë së Bujqësisë, deri në kryqëzimin me rrugën “Ibrahim Rugova”, ngjitur me Katedralia Ortodokse (e re) “Ngjallja e Krishtit”, në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 8/VII, gërma “b” dhe nenit 32, gërma “ll” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), si dhe nenit 3 të ligjit nr.9270, datë 29.07.2004 për “Sistemin e adresave” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë emërtimin “Shëtitorja e Katedrales”, të rrugës nga sheshi Skënderbej, në kryqëzimin midis Ministrisë së Energjitikës dhe Ministrisë së Bujqësisë, deri në kryqëzimin me rrugën “Ibrahim Rugova”, ngjitur me Katedralia Ortodokse (e re) “Ngjallja e Krishtit”. (sipas hartës bashkëlidhur këtij vendimi).
  2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit si dhe Drejtoria e Planifikimit të Territorit.
1. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI**

**ALDRIN DALIPI**